SHNDËRRIMI I QYTETIT TË NDOTUR NË QYTET TË GJELBËR

TEMA: Roboti micro:Maqueen Plus në edicionin e gjashtë të Garës së Robotikës, nën temën "Eko Aventura", po fillon misionin për ruajten e ambientit.
Këtë aventurë të re po e nis në qytetin e tij, ku ka vërejtur që ka shumë ndotje dhe aspak gjelbërim. Gjatë udhëtimit të tij ai do të mbledhë mbeturinat, do i ndajë ato për riciklim sipas llojit, do të japë mesazhe vetëdijesuese tek qytetarët për ruajtjen e ambientit, do të vendosë stacione për mbushjen e makinave elektrike me energji elektrike dhe do të mbjellë pemë të ndryshme.
Qëllimi i tij është që të përfundojë udhëtimin e tij të parë, duke e shndërruar qytetin nga një qytet të ndotur në një qytet të gjelbër.



Përpara se roboti të fillojë ekzekutimin e sfidës, duhet të vendoset në segmentin për kalibrim, ashtu siç tregohet në figurë dhe të kalibrohet. Me pas, roboti duhet të vendoset mbi segmentin me numër '1' (para vijës së kuqe), ashtu siç tregohet në figurë.
Në gjendjen POWER ON roboti duhet t'i ketë të gjitha diodat e fikura.
Për të nisur robotin duhet të shtypni butonin 'A' në pllakën micro:bit.
Pasi të shtypni butonin 'A', roboti ndez të gjitha diodat RGB në ngjyrën e kaltër dhe LED diodat.
*Roboti duhet të mbajë të gjitha diodat RGB në ngjyrë të kaltër, të ndezura nga segmenti me numër '1' deri tek segmenti me numër '11', dhe po ashtu duhet të mbajë LED diodat të ndezura nga segmenti me numër '1' deri tek segmenti me numër '11'

Menjëherë pas ndezjes së diodave RGB dhe LED diodave, roboti gjen vijën e zezë dhe fillon ndjekjen e saj me anë të sensorit për ndjekjen e vijës (Line Tracking Sensor).
*Roboti duhet të ndjekë vijën e zezë nga segmenti me numër '1' deri te segmenti me numër '11'. Kur roboti arrin në segmentin me numër '11', roboti ndalet me të tre rrotat brenda segmentit.
Roboti ndalet duke aktivizuar sensorin e distancës (Ultrasonic Sensor) me anë të një kutie që vendoset ashtu siç tregohet në figurë. Menjëherë sapo të ndalet, roboti fik të gjitha diodat RGB dhe LED diodat. Sapo të fik diodat, roboti luan melodinë e plotë 'ENTERTAINER'.

